



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

## **K.DH.SH.II.nr.902/22**

**Gjykata Komeriale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, Shoqëria “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Arbër Istrefi avokat nga Prishtina, për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.86/2019 e datës 20/11/2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/10/2022, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit, “Shoqëria “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, e datës 21.01.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike- III.C.nr.86/2019 e datës 20/11/2020, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar III.C.nr.86/2019 e datës 20/11/2020, ka vendosur që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses Shoqëria “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar si vijon :

Të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë që paditësit t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës publike për furnizimin me shujta për nxënësit e klasave të ulëta (1-5) të shkollave të Komunës së Prishtinës për shkak të borxhit në shumën e përgjithshme prej 499,064.12euro dhe atë në emër të;

-Dëmit të shkaktuar për shkak të mbylljes së furrës në Matiqan në shumë prej 50.000 euro, mbylljes së restorantit “...” në Prishtinë (në lokacionin e objekti të ..., magjstralja Prishtinë -Fushë Kosovë në shumë prej 120,000.00 euro,

-Kompensimin e dëmit në emër të konfiskimit të garancionit për përmbushjen e kontratës mbi bazën e konfiskimit nga Kompania e Sigurimeve në vlerë prej 39,064.12 € (14,893.04 euro Kompania “...” dhe 24,171.00 euro Kompania “...”),

-Mbi bazën e fitimit të humbur për shkak të pamundësisë së përmbushjes së kontratës nga ana paditësit se në bazë të ndërprerjes së njëanshme të kontratës në shumën prej 75.000.00 euro, në emër të borxhit kryesor me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, dhe

- Dëmtimit të emrit dhe imazhit të paditësit në tregun e Kosovës për shkak të aktit administrativ-vendimi për ndërprerjen e njëanshme të kontratës si dhe shumën prej 215.000.00 euro.

Detyrohet paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj të paditurës shumën prej 845.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe që çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura ka dhënë përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e paditëses të hedhet poshtë si e pas afatshme, apo nëse është dorëzuar me kohë, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Paditësi Shoqëria “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi me datën 13.02.2019, ndaj Komunës së Prishtinës me seli në Prishtinë, duke kërkuar që e paditura t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 499,064.12 euro, dhe atë; dëmin e shkaktuar për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës publike për furnizimin me shujta për nxënësit e klasave të ulëta (1-5) të shkollave të Komunës së Prishtinës

, në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të mbylljes së furrës në Matiqan në shumë prej 50.000.00euro, mbylljes së restaurantit “...” në Prishtinë (në lokacionin e objektit e objektit të ...., magjistratja Prishtinë -Fushë Kosovë në shumë prej 120,000.00 euro, kompensimin e dëmit në emër të konfiskimit të garancionit për përmbushjen e kontratës mbi bazën e konfiskimit nga Kompania e Sigurimit në vlerë prej 39,064.12 € (14,893.04 euro-Kompania “...” dhe 24,171.00 euro Kompania “...”), ndërsa shumë prej 75.000.00 euro në emër të fitimit të humbur për shkak të pamundësisë së përmbushjes së kontratës nga ana paditësit se në bazë të ndërprerjes së njëanshme të kontratës, si dhe shumë prej 215.000.00 euro në emër të dëmtimit të emrit dhe imazhit të paditësit në tregun e Kosovës për shkak të aktit administrativ-vendimi për ndërprerjen e njëanshme të kontratës me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar dhe atë konform dispozitave të nenit 357 paragrafi 3 lidhur me nenin 355 paragrafi 1 të LMD-së, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit se nuk mund të ketë parashkrim për shkak se paditësi me të paditurën kanë pasur marrëdhënie kontraktuale ndërmjet autoritetit publik dhe operatorit ekonomik, ku si titull i kontratës ka qenë ; “Kontrata Publike Kornizë, Kushtet dhe Anekset e Ndërlidhura” e që bazë e së njëjtës ka qenë Ligji për Prokurimin Publik dhe jo Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore, mirëpo gjykata këtë pretendim e konsideron si të pabazuar ngase Ligji i prokurimit parasheh dhe rregullon procedurat për ofrertimin, zgjedhjen dhe lidhjen e kontratës, ndërsa detyrimet dhe obligimet rregullohen në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve që do të thotë me Ligjin e Prokurimit rregullohet procedura dhe përzgjedhja e ofertuesit, ndërsa mënyra e kontraktimit dhe kushtet e kontraktimit i rregullon Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimeve. Ligji mbi Prokurimin nuk përmban dispozita të veçanta apo speciale, që rregullon detyrimin dhe obligimet kontraktuese.

Mbi këto arsye gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 374, nenin 371 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzime e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.2 të LPK-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë të pathemelta qëndrojnë pretendimet ankimore (*pretendime të kuptuar në arsyetimi i ankesës*) të palës ankuese se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë si dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale (*pretendime të kuptuar në arsyetimi i ankesës*) sepse me provat e administruara gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, nga fakti se nga njoftimi për ndërprerjen e kontratës së datës 16.04.2015, ka vërtetuar faktin lidhur me kohën e afatshme për paraqitjen e kërkesës lidhur me përmbushjen e detyrimit, kështu që nga data 16.04.2015, si datë e fundit kur paditësi pretendon se i është shkaktuar dëmi me ndërprerjen e kontratës e deri me datë 13.02.2019, si datë e paraqitjes së padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite, andaj edhe është përmbush kushti ligjor për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar duke iu referuar dispozitave të nenit 357 paragrafi 3 lidhur me nenin 355 paragrafi 1 të LMD-së në të cilën është paraparë në mënyrë decidive se “*Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi*”, si dhe është paraparë se “*kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri vite*”, që nënkupton se paditësja padinë e ka ushtruar pas kalimit të afatit prej 3 vite,

andaj mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar rezulton se gjykata e shkallës së parë drejte e ka zbatuar nenin 374 të LMD-së e cila dispozitë parasheh më sa vijon: Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet ankimore lidhur me çështjen se në rastin konkret bëhet fjalë për kontratë publike, mirëpo gjykata bën me dije se marrëdhëniet kontraktuale dhe pretendimi i dëmeve lidhur me këto marrëdhënie që burojnë nga kontratat komerciale sipas Ligjit të Prokurimit Publik nuk e ndryshojnë afatin e parashkrimit dhe se Ligji për Prokurimin Publik nuk rregullon afatet e as kërkesat, por i njëjti rregullon procedurën e tenderimit dhe prokurimit publik dhe se në rastin konkret vlejnë dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve neni 355 par.1.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditeses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë.

Dhoma e Shkallës së dytë vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur në përgjigje në ankesë se ankesa e paditëses është e paafatshme, mirëpo kjo gjykatë gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi që paditësi aktgjykimin e ka pranuar me datë 12.01.2021, ndërsa ankesën e ka protokoluar në postë me datën 19.01.2021, cka vërtetohet përmes vulës së protokolit të postës e cila është e vendosur në pliko, ndërsa në gjykatë ka arritur me datë 21.01.2021. Kështu që kjo gjykatë vlerëson se ankesa është e afatshme sepse si ditë e dorëzimit të ankesës konsiderohet dita kur ankesa është vendosur në postë.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje

juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË**

**DHOMA E SHKALLES SE DYTË**

**K.DH.SH.II nr.902/22, me datë 13.10.2022**

Gjyqtarja-Kryetare e Kolegjit

Saranda Bogaj-Sheremeti